

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretaren juridike Sanije Troshupa, në çështjen penale kundër të pandehurit F.S., nga P., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3531/2017, të dt:28.03.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP.II.nr.3531/2017, të dt:28.03.2018, më **11.05.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3531/2017, të dt:28.03.2018, dhe gjykata nxjerr këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

#### I pandehuri:

**F.S.**, nga i ati Xh., e ëma N., e gjinisë S.1, i lindur me datë ..., në Rr."S.2", nr.24, Komuna P.2, ku dhe jeton, me numër personal ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

#### S e p s e:

Me datë 14.04.2017, rreth orës 11:12h, në parkingun "B.", Rr."M.", në P.3, i pandehuri ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin Sh.S. në atë mënyrë që, derisa i dëmtuari ishte duke punuar në vendin e tij të punës në parkingun "L.", aty kishte ardhur i pandehuri duke kërkuar një kupon fiskal, pastaj të dëmtuarit i'a kërkon një mjet sportiv Skejtbord të cilin e kishte në posedim i dëmtuari, pasi që i njëjti refuzon, atëherë i pandehuri në shenjë revolte duke përdorur grushte dhe shqelma e godet të dëmtuarin në tërë trupin duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore;-

**Me këtë ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 23, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurit F.S. i shqipton këtë:

### DËNIM ME GJOBË

I pandehuri: **F.S.** dënohet me gjobë në shumë prej **300.00 € (tre qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën mjeko ligjore shumë prej **20€**, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej **20€**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: Sh.S., me vendbanim në fshatin R., Komuna P.4, ku dhe jeton, për realizimin e kërkesës pasuror juridike, udhëzohet në kontest të regullt civilo – juridik.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me PP.II.nr.3531/2017, të dt:28.03.2018, ka akuzuar F.S., se ka kryer veprën penale – Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me rsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Policisë së Kosovës nr.2017-AB-1209 të datës 30.05.2017, akt ekspertimi mjeko-ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes nga Dr. Prof. asoc. N.H. i datës 31.01.2018, deklarata e të pandehurit e dhënë në procedurën paraprake, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri F.S., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqyrtimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr.1689/2018 të dt. 11.05.2018**

**Procesmbajtësja,  
Sanije Troshupa**

**G j y q t a r i  
Rrustem Begolli**

#### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.